



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: ARTE

LËNDA: TEATËR

KODI: 1.4

PROGRAMET E LËNDËS TEATËR PËR KLASAT 10-12

TIRANË, SHTATOR 2008

Lënda e teatrit, së bashku me lëndët e tjera brenda fushës së arteve, që u ofrohet nxënësve në gjimnaz, kërkon që përmes njohurive dhe aftësive të përftuara përmes kësaj lënde, të sigurojë një orientim të drejtë dhe të mirëpërcaktuar për një formim dhe edukim kulturor, jo vetëm gjatë shkollës, por përgjatë gjithë jetës. Kjo gjë i ndihmon ata të vlerësojnë botën në mënyrë krijuese dhe kritike në perspektivën e aspekteve të tilla që edukon arti siç janë: *ndjenjat, imagjinata, shpirti njerëzor, humanizmi, dashuria dhe liria*. Në mënyrë të veçantë teatri, duke qenë një art ansambël, do t'u japë mundësi të rinjve të edukohen *me frymën demokratike të respektit reciprok për njëri-tjetrin*, të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit, përmes një komunikimi artistik qytetar dhe të drejtë. Ata do të mund të kultivojnë cilësi të tilla si lirshmërinë, aftësinë për të folur bukur gjuhën amtare, si dhe guximin për t'u shprehur përmes fuqisë së fjalës.

Lënda e teatrit do t'u japë të rinjve mundësi që të kenë një krijimtari të tyre në këtë fushë që do t'i motivojë ata të përfshihen në mënyrë aktive në jetën teatrale- artistike të shkollës, komunitetit dhe në rang vendi.

Duke qenë se teatri është një laborator ku studiohen sjelljet njerëzore, përmes studimit të kësaj lënde, me qëllimin dhe arritjet e synimeve kryesore të saj, nxënësit do të mësojnë të njohin vetveten dhe të tjerët, duke përmbushur në këtë mënyrë kontributin:

- në zhvillimin personal të tyre,
- që ata ta shohin veten si pjesë e shoqërisë dhe kontribuues aktivë në të,
- në thellimin e studimeve në të ardhmen,
- në përgatitjen e nxënësve si qytetarë aktivë të një shoqërie evropiane.

1. SYNIMI I LËNDËS

Ky program synon:

Të orientojë nxënësit drejt njohjes së aspekteve estetike dhe artistike të teatrit, si dhe vlerësimit kritik dhe analitik të tyre, duke i njohur me elementet dhe parimet e artit skenik, duke u dhënë mundësinë atyre të depërtojnë në sekretet e krijimtarisë teatrale dhe të asaj që përbën tërësinë e një përvoje teatrale, si dhe duke kaluar nëpër një proces konkret realizimi, ku do të fitojnë disa shprehje fillestare që kanë të bëjnë me aftësitë interpretuese skenike. Lënda përmban gjithashtu një panoramë të zhvillimit historik të teatrit në kontekste dhe kultura të ndryshme.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi nxënës/i, - ja:

- Të shquajë elementet estetike në vepra të ndryshme teatrale dhe të bëjnë një vlerësim kritik dhe analitik të tyre, duke i ballafaquar ato edhe me arte të tjera;
- Të kuptojë dhe të përdorin konkretisht elementet dhe parimet bazë të teatrit;

- Të zhvillojë aftësitë komunikuese të të shprehurit saktë dhe bukur nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në procese realizimi teatral;
- Të dallojë periudhat kryesore historike nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i teatrit;
- Të kuptojë përdorimin e teknologjisë në zhvillimin e teatrit;
- Të ndjekë aktivisht jetën teatrale në komunitetin e tyre dhe në vend;
- Të demonstrojë aftësitë e tyre në teatër, duke e parë atë si mundësi për karrierë.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

54 javë x 1 orë = 54 orë

Linja 1: Estetika e arteve dhe teatri¹

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë ka një nxënës me disa ligje të përgjithshme të estetikës që karakterizojnë artin në përgjithësi dhe krijimtarinë artistike në veçanti, siç mund të jenë njohja me *objektin e artit, kategoritë estetike, klasifikimi i arteve* dhe lidhja e tyre me njëri-tjetrin. Këto ligje të përgjithshme të artit dhe specifika e tij në raport me veprimtari të tjera të njeriut dhe shoqërisë, do të shërbejnë si urë për të kaluar në njohjen e specifikave estetike dhe krijuese të teatrit në një aspekt të përgjithshëm.

Orët e sugjeruara²: 5

Linja	Objektiva
Estetika e arteve dhe teatri	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë artet si pjesë e objektit të <i>estetikës</i>; • të dallojë <i>cilësitë estetike</i> në një vepër konkrete arti (muzikë, teatër, art pamor dhe kërcim); • të klasifikojë artet: muzikë, art pamor, kërcim dhe teatër, sipas <i>mjeteve të tyre shprehëse</i>; • të përshkruajë dallimin midis <i>artëve të thjeshta</i> dhe

1. Estetika do të zhvillohet nga përdoruesit e programit (mësuesit dhe autorët e teksteve si një linjë e përbashkët, *nëse do të jetë një tekst për të katër lëndët*, pasi edhe çështjet e vendosura si kërkesë për studim janë të njëjta, duke veçuar vetëm klasifikimin e arteve sipas mjeteve të tyre shprehëse). Orët e estetikës, pikërisht në objektivat me përmbajtje të përbashkët, realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Edhe objektivat që lidhen specifikisht me lëndën e zgjedhur do të shpjegohen dhe realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Orët e mbledhura për të dyja lëndët e përzgjedhura janë 10 orë, nga të cilat 4 orë mund të përdoren për shpjegimin e kuptimit të përgjithshëm të estetikës për të gjitha artet dhe 6 orët e mbetura mund të planifikohen sipas specifikave estetike të lëndës së përzgjedhur (3+3).

² Orët e sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesi/ja), që të shtojë ose të pakësojë numrin e sugjeruara të orëve në masën 10 % sipas nevojave të klasës.

	<p>arteve të përbëra;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë lidhjet e llojeve të ndryshme të arteve me njëri- tjetrin; • të përshkruajë ndryshimin e shijeve estetike teatrore, duke u nisur nga krahasimi i dy veprave të periudhave të ndryshme; • të argumentojë parapëlqimet e veta artistike në grup, familje etj., (si p.sh. pse i pëlqen një vepër e Shekspirit nga një vepër teatrore e shek. XX); • të shkruajë një ese ose një artikull kritik mbi vlerat estetike të një vepre skenike, të një periudhë të caktuar; • të shpjegojë rrugët përmes të cilave duhet të orientohet për të parë një shfaqje artistike p.sh.: <i>llojin e shfaqjes, ku dhe kur zhvillohet, rregullat para, gjatë dhe pas shfaqjes etj.</i>
--	--

Linja 2: Elementet dhe parimet e teatrit

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë u prezanton nxënësve elementet kryesore të teatrit si *aktorin, spektatorin, skenën, dramaturgun, regjisorin etj.* Ata njihen me sekretet që përbëjnë tërësinë e një përvoje teatrale dhe kuptojnë se teatri nuk mund të jetë asnjë nga elementët të marrë veçmas, as shuma e tyre e thjeshtë, por ansambli i tyre i shkrirë në një. Aftësitë e *analizës, sintezës, qëndrimit kritik, zbërthimit të formës dhe përmbajtjes së një shfaqjeje skenike* zhvillohen përmes kësaj linje.

Orët e sugjeruara: 7

Linja e dytë	Objektiva
Elementet dhe parimet e teatrit	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë <i>elementet kryesorë</i> që përbëjnë tërësinë e një përvoje teatrale dhe parimin e tij të ansamblit; • të njohë <i>alkiminë</i> e kontaktit të <i>aktorit me spektatorin</i> dhe rolin që luan publiku në teatër, duke u bërë pjesëmarrës në to; • të dallojë <i>zhanre</i> të ndryshme teatrale; • të ndërjegjësohet për <i>strukturën dramatike</i> dhe <i>karakterin dramatik</i>; • të shpjegojë rolin kyç që luan <i>dramaturgu</i> dhe <i>dramaturgjia</i> për zhvillimin e teatrit; • të identifikojë <i>aktorin</i> si qendrën e skenës dhe <i>regjisorin</i> si udhëheqësin e teatrit; • të kuptojë <i>rolin e skenografit</i> dhe <i>elementet vizivë të shfaqjes, arkitekturën skenike, kostumet, dritat, efektet skenike</i>;

	<ul style="list-style-type: none"> të analizojë këto elemente nëpërmjet ndjekjes së vazhdueshme të jetës teatrore që do të finalizohet përmes një ese-je ku demonstrohen qartë aftësitë e tyre në <i>analizën, sintezën, qëndrimin kritik, zbërthimin e formës dhe përmbajtjes së një shfaqjeje.</i>
--	---

Linja 3: Procese të krijimit dhe realizimit skenik

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë zhvillohet përmes orëve praktike: *lojëra teatrale, etyde improvizimi, ushtrime për ta çliruar nxënësin të shprehet në publik, ushtrime të fjalës artistike* që çojnë në realizimin e *një tregimi, poezie dhe monologu* dhe ku preken apo praktikohen tema të tilla si: komunikimi dhe veprimi nëpërmjet fjalës, shprehja e emocioneve dhe ideve nëpërmjet fjalës. Monologu mund të shërbejë edhe për të zhvilluar aftësinë aktorese, për t'u transformuar në një karakter (personazh) dhe për ta konkretizuar atë nëpërmjet *nëntekstit, pauzës, veprimit dhe konfliktit të brendshëm* etj. Gjithashtu në orët e kësaj linje futen edhe elementë plastikë, pa fjalë, si p.sh.: *antomima dhe ushtrime me "sikur"* (*ushtrime me gjeeste mimike dhe plastike*). Orët praktike duhet të shërbejnë edhe si orë diksioni dhe të të folurit saktë dhe bukur të gjuhës shqipe: individualisht evidentohen cilësitë e të folurës së gjithsecilit nxënës/e, -je defektet që mund të kenë, ushtrime për kapërcimin e tyre etj.

Orët e sugjeruara: 21

Linja	Objektiva
Procese të krijimit dhe realizimit skenik	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të zhvillojë <i>aftësinë për të krijuar dhe improvizuar lirshëm në publik;</i> të aftësohet <i>të veprojë nëpërmjet fjalës;</i> të komunikojë dhe të veprojë nëpërmjet <i>fjalës;</i> të realizojë <i>një tregim, një poezi dhe një monolog</i>, duke u bërë <i>i/e ndjeshëm/me ndaj aftësisë që ka fjala për të krijuar karakterin e personazhit;</i> të kuptojë <i>ç'është veprimi</i> nëpërmjet etydeve të improvizimit, duke arritur të rrokë <i>karakterin e tij psiko-fizik;</i> të dallojë <i>ngjarjen në jetë dhe ngjarjen në skenë, rrethanat në jetë dhe rrethanat në skenë;</i> të realizojë <i>etydin</i> si një nga njësitë më të vogla të një shfaqjeje dramatike <i>me elementet e tij kompozicionale, fabula, subjekti, ngjarja, tema, ideja etj.;</i> të zhvillojë aftësinë për të vepruar <i>me sikur</i> dhe pa fjalë nëpërmjet ushtrimeve <i>të plastikës trupore.</i>

Linja 4: Historia e teatrit, bota dhe shoqëria

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë përveç njohjes me zhvillimin e teatrit në periudha të ndryshme historike, përcakton edhe ndikimet e karakteristikat e tij historike, shoqërore dhe kulturore në këto periudha. Nxënësit do të studiojnë paralelisht zhvillimin e elementeve kryesorë që përbëjnë teatrin, zhvillimin e dramës, skenës, të interpretimit të aktorit dhe të regjisorit etj. Në këtë linjë nxënësve do t'u jepet mundësia të thellojnë aftësitë e tyre kritike dhe analitike nëpërmjet detyrave që do të kryejnë gjatë analizave historike, sociale, stilistike, dramaturgjike të disa prej veprave më të shquara dhe më përfaqësuese të dramaturgjisë botërore dhe asaj shqiptare.

Gjithashtu, do të preken edhe linjat më kryesore të zhvillimit të teorisë dhe filozofisë së teatrit, shkolla, stile, tendenca të ndryshme të zhvillimit të teatrit.

Orët e sugjeruara: 16

Linja	Objektiva
Historia e teatrit, bota dhe shoqëria	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të klasifikojë zhvillimet e artit skenik në shoqërinë në periudha të ndryshme historike, prej antikitetit deri në ditët e sotme (antikitet, mesjetë, rilindje, romantizëm, moderne etj.) duke u mbështetur në karakteristikat <i>specifike, historike, stilistike dhe estetike</i> të veprave të veçanta;<ul style="list-style-type: none">> Njohuri për teatrin - gjinitë teatrale.> Teatri antik dhe origjina e teatrit grek. Përfaqësuesit e saj;> Autorët e teatrit antik greko-romak:<ul style="list-style-type: none">- komedia greke,- komedia romake.> Teatri shqiptar:<ul style="list-style-type: none">- Teatri në antikitet- Teatri folklorik- Teatri në periudhën e Rilindjes Kombëtare.> Teatri në periudhën:<ul style="list-style-type: none">- 1912- 1945- pas vitit 1945- Teatri në dekadën e fundit- Komedia e artit.> Teatri gjatë Rilindjes evropiane:<ul style="list-style-type: none">- Teatri italian- Spanjoll gjatë Rilindjes- Formimi i dramës spanjolle- Teatri anglez në periudhën e Rilindjes- Krijimtaria e Shekspirit.> Teatri i klasicizmit francez dhe përfaqësuesit e

	<p>klasicizmit.</p> <ul style="list-style-type: none"> > Teatri iluminist dhe romantik: <ul style="list-style-type: none"> - Teatri francez i shek. XVIII - Drama romantike franceze Dramaturgjia angleze e shek. XVIII - Teatri italian në shek. XVIII > Teatri gjerman i shek. XVIII- XIX dhe Teatri romantik gjerman > Teatri rus i shek. XIX > Teatri realist dhe ai modern. Teatri ekzistencialist. > Teatri absurd > Rryma, shkolla, stile teatrore. Reformatorët e teatrit. <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë kërkimet, krahasimet, diskutimet dhe debatin rreth zhvillimit të kulturës skenike, si dhe veprave e përfaqësuesve kryesorë shqiptarë apo të huaj; • të analizojë një vepër arti duke u mbështetur në disa kriterë: <ul style="list-style-type: none"> - periudhën dhe autorin, - ndikimet, - mjedisin social e shoqëror ku u krijua vepra, - mesazhi që përcjell. • diskutojë <i>ndikimet</i> e një zhanri teatral tek vetja dhe tek shokët, pa paragjykuar mendimet e të tjerëve; • të vlerësojë <i>rolin</i> dhe <i>funksionin</i> e teatrit në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton komunitet dhe shoqëri, duke kontribuar si pjesëtar aktiv në të; • të krahasojë veprat e artit skenik sipas <i>specifikave</i> ose <i>stileve historike</i>; • të përdorë elementet skenikë për të ngritur një argument, opinion, mendim etj., dhe si mjet shprehës në punët e veta përmes një ese-je, diskutimi, projekti kurrikular etj); • të debatojë mbi një vepër teatrore, duke e nisur analizën nga përdorimi i elementeve skenikë; • të analizojë <i>cilësinë</i> e realizimit të veprave të ndryshme skenike, duke përdorur një fjalor të përshtatshëm artistik; • të përshkruajë lloje të ndryshme të karrierës në teatër, duke u mbështetur në llojin dhe nivelin e arsimimit e talentin, kushtet e punës, mundësitë e punësimit, pagën.
--	--

Linja 5: Teknologjia dhe media

Përshkrimi i linjës: Përmes realizimit të kësaj linje nxënësit njohin dhe vlerësojnë rolin që ka pasur dhe ka zhvillimi teknologjik në pasurimin e teatrit me mjete të reja, më të përsosura shprehjeje, sidomos në drejtim të teknikës skenike, fonia dhe ndriçimi, por edhe në zhvillimin e makinerisë skenike, sidomos roli i teknologjisë në zhvillimin e kinemasë. Gjithashtu, nxënësit do të studiojnë rolin e medias në lidhje me teatrin, duke u bërë më të ndjeshëm për aftësitë e tyre në këtë fushë.

Orët e sugjeruara: 5

Linja	Objektiva
<p>Teknologjia dhe media</p>	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë ndikimin që ka pasur dhe ka <i>zhvillimi teknologjik</i> për teatrin; • të analizojë lidhjen shumë të ngushtë që ka pasur dhe ka zhvillimi i shkencës dhe i teknologjisë me <i>zhvillimin e kinemasë</i>; • të përshkruajë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve më të domosdoshme në skenë si: <i>dritat, fonia, efektet skenike, makineria teatrale etj.</i>, në raport me zhvillimin teknologjik; • të shpjegojë etapat që kalon <i>procesi</i> i realizimit të një shfaqjeje teatrale që nga fillimi i provave deri në kontaktin me spektatorin, në perspektivën e <i>menaxhimit dhe marketingut</i> në teatër; • të përdorë media të ndryshme për <i>promovimin</i> e një shfaqjeje teatrale si: <i>postera, fletëpalosjet, reklama etj.</i>

4. KËRKESA TË TEATRIT NDAJ LËNDËVE TË TJERA

DRAMA	GJUHA SHQIPE
<p>Fjala dhe roli i saj si mjet kryesor në interpretimin e aktorit. Të folurit skenik: <i>Veprimi nëpërmjet fjalës, përshtatja, komunikimi i ndjenjave nëpërmjet fjalës, emocioneve, ideve, qëllimeve të shfaqura dhe të pashfaqura të njeriut në jetë dhe aktorit në skenë, nënteksti etj.</i></p>	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të njihet dhe të praktikojë shqiptimin e saktë të zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. ▪ të njihet dhe të praktikojë diksionin e fjalës, shqiptimin e saktë të saj. ▪ të përdorë elementet e teknikës së theksit logjik dhe emocional, si dhe rolin e intonacionit në komunikim. ▪ të njihet dhe të praktikojë për të zotëruar stile të ndryshme të së folurës dhe identifikuar forcën që mbart fjala për të individualizuar njeriun në jetë dhe personazhin në skenë.

DRAMA	LETËRSIA
<p>Analiza e një vepre dramatike me të gjithë elementët strukturorë të saj.</p> <p>Zhvillimi historik i dramaturgjisë nëpër etapa të ndryshme: Antikiteti, Rilindja, Klasicizmi, Romantizmi, Iluminizmi, Realizmi, Drama bashkëkohore etj.</p> <p>Drama si gjini letrare krahasuar me gjini të tjera letrare, proza, poezia etj.</p> <p>Studimi i mjeteve të shprehjes artistike: metafora, simboli etj, studimi i shkollave, rrymave dhe tendencave letrare dhe filozofike që pasqyrohen në dramaturgji dhe në teatër si realizmi, natyralizmi, ekspresionizmi, simbolizmi, absurdi, ekzistencializmi, surealizmi, etj.</p>	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të bëjë analizën e një vepre letrare që në thelb është e njëjtë me analizën e një vepre dramatike. Zbulojë temën, idenë, stilin, konfliktin; analizon personazhet, përshkruan strukturën kompozicionale, etj. ▪ të njohë etapat e ndryshme të zhvillimit të artit dhe letërsisë, duke përshkruar karakteristikat kryesore të tyre. ▪ të bëjë krahasimin e gjinive të ndryshme letrare, duke identifikuar specifikat e tyre sidomos specifikat e dramës si gjini letrare e destinuar për në skenë. ▪ të njohë larminë e figurave artistike letrare dhe t'i përshtasë ato në gjininë dramatike si dhe me tendencat e ndryshme letrare dhe filozofike që kanë pasur pasqyrimin e tyre edhe në dramaturgji dhe në teatër.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtarë për lëndën e teatrit. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare të arteve ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit;
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare;
- Vlerësimin të nxënësit me notë;
- Parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtarë (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programin lëndor të lëndës së teatrit.

Fusha e arteve vjen për herë të parë në **gjimnaz** në mënyrë të plotë përsa i përket kohës, përmbajtjes dhe strukturës, duke zhvilluar përmbajtjet e katër lëndëve, të cilat janë: muzika, arti pamor, teatri dhe kërcimi. Studimi i dy prej këtyre lëndëve mund të jenë kombinimet: a) *muzikë – kërcim* b) *art pamor – teatër*, apo edhe kombinime të tjera. Fusha e arteve për herë të parë ka një pamje të plotë, duke zhvilluar katër lëndë brenda saj me një përmbajtje të mjaftueshme kulturore për qëllimin që ka shkolla e mesme publike.

Teatri në **gjimnaz** vjen për herë të parë si lëndë më vete dhe studiohet në 54 orë mësimore, përkatësisht në 3 semestra me nga 1 orë në javë. Raporti i vëllimit midis njohurive dhe veprimtarive në lëndën e teatrit, ndryshe nga lëndët e tjera të gjimnazit, është 50 me 50, pasi kjo lëndë synon shumë në zhvillimin e aftësive përmes realizimit të *lojërave teatrale, etydeve të improvizuara, të një tregimi, poezive dhe monologut*.

Kurrikula e teatrit e konceptuar për gjimnazin do të zgjerojë përvojat e fituara nga nxënësit përmes studimit të pjesëve letrare në gjuhën shqipe në arsimin e detyruar, duke zhvilluar më tej aftësitë e tyre krijuese, duke shprehur emocionet në realizime konkrete artistike. Programi i teatrit organizohet sipas linjave të përmbajtjes dhe për çdo linjë shënohen objektivat të cilat materializojnë njohuri mbi teatrin, aftësi dhe qëndrime që pritet të nxënë nxënësit gjatë studimit të përmbajtjes së këtij programi.

Në përmbajtjen e programit të teatrit në gjimnaz synohet realizimi i krijimeve të ndryshme artistike, jo më në mënyrë spontane, por në mënyrë profesionale, duke pretenduar një performancë artistike.

Gjithashtu, studimi i këtij arti skenik nga lashtësia deri në ditët tona, kërkon që nxënësit, jo të memorizojnë dhe riprodhojnë në mënyrë mekanike periudhat historike, veprat dhe përfaqësuesit e çdo periudhe, por të krahasojnë, të ngrenë hipoteza, të përshkruajnë dhe të mbajnë qëndrim duke vlerësuar opinionet e gjithsecilit.

Zbatimi i programit të teatrit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Zhvillimi i të menduarit kritik për vlerësimin e një vepre skenike.

Zhvillimi i qëndrimit kritik dhe aftësisë për të interpretuar në mënyrë artistike një vepër skenike, është një nga detyrat e mësuesit. Në përdorimin e përditshëm, termi “kritik” ka ngjyresën e një qëndrimi mosmiratues, kurse këtu ka të bëjë me analizën, sintezën dhe vlerësimin si procese mendore tipike. Të menduarit kritik del i domosdoshëm në rastet e zgjidhjes së një situatë problemore ose të marrjes së një vendimi. Pjesë e rëndësishme e të menduarit kritik është kujdesi i posaçëm dhe i përhershëm ndaj paragjykimeve vetjake ose të tjerëve, anësisë, keqinformimit etj. Mësuesit duhet t’i japin mundësinë secilit nxënës që të kultivojë të menduarin kritik ndaj informacioneve, ngjarjeve, dukurive dhe qëndrimeve artistike.

Për zhvillimin e kësaj lënde një rol të rëndësishëm ka mjedisi ku do të punohet, një studio apo klasë e madhe që të mundësojë zbatimin me sukses të linjave e programit. Linjat e elementeve dhe parimeve, si dhe proceset e realizimit mundësojnë punën krijuese të nxënësve, ku ata duhet të punojnë në mënyrë individuale dhe në grup.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia për të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Orët e estetikës, pikërisht në objektivat me përmbajtje të përbashkët, realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Ndërsa objektivat që lidhen specifikisht me lëndën e zgjedhur do të shpjegohen dhe realizohen nga secila lëndë më vete. Orët e mbledhura për të dyja lëndët e përzgjedhura janë 10 orë, nga të cilat 4 orë janë shpjegimin e kuptimit të përgjithshëm të estetikës në të gjitha artet dhe 6 orët e mbetura do të ndahen sipas specifikave estetike të lëndës së përzgjedhur (3+3).

P.sh.: Objektivi: “Të shpjegojë artet si pjesë e objektit të *estetikës*” kërkon që të gjithë nxënësit duhet të njohin estetikën si një shkencë që studion artet dhe të përkufizojnë objektin e saj. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh.: Objektivi: “Të realizojë *monologun*, duke u bërë i ndjeshëm ndaj aftësisë që ka fjala për të krijuar karakterin e personazhit” kërkon që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të realizojnë dhe të shfaqin një *monolog*, por jo nga të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel interpretimi.

Një nivel do të ishte veprimi organik përmes fjalës për të transmetuar nëpërmjet monologut ide dhe emocione të fuqishme. Por një tjetër nivel akoma më i lartë, do të ishte shfaqja e aftësive për të krijuar një karakter brenda monologut. Një nivel edhe më i lartë do të ishte ndërthurja e elementeve të monologut me aftësi të tjera të linjës si p.sh kostumi, elementë të skenografisë, të konceptit regjisorial, etj.

- Përsëritjen brenda një linje të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhëse;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integritime do të përshkojë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Orët mësimore

Programi i teatrit është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia- mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë.

Domethënë, mësues/i,-ja mund të vendosë të vazhdojë më ngadalë kur vë re se nxënësit, hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të linjës, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së teatrit, afërsisht **50%** e totalit të orëve mësimore janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **50%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një linje të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhëse;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera brenda fushës së arteve dhe më tej (me fizikën, gjuhën shqipe). (Ndonëse këto integrame do të përshkojë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

Aftësi të posaçme lëndore:

- krijuese – krijimin e një ese-je mbi një vepër të caktuar të artit skenik, duke sjellë një opinion dhe qëndrim të vetin;
- krijuese - realizimin e një pune të vetën (etyd, monolog etj.), duke përcjellë emocionet dhe ndjeshmërinë individuale;
- komunikuese – komunikimin e saktë të njohurive, opinioneve, mendimeve dhe qëndrimeve rreth artit skenik;
- analizuese - analizimin e një veprë dramaturgjike përmes elementeve dhe parimeve të artit skenik, nga të cilat përbëhet një vepër, dhe që ndihmojnë për të patur një fjalor të saktë artistik gjatë analizës së një veprë;
- krahasuese – krahasimin dhe renditjen e karakteristikave të dy veprave teatrale nga autorë të ndryshëm, por që i përkasin të njëjtës periudhë historike.
- ***Formimit të qëndrimeve***, si qëndrimi etiko-social etj., dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohej mundësia të punojnë detyra bazuar mbi një tematikë të caktuar, ose një projekti kurrikular etj.

Një nga kërkesat për zbatimin me sukses të këtij programi është edhe zhvillimi i punës me nxënësit që mund të kenë vështirësi me të folurën për të realizuar një detyrë të dhënë (poezi, etyd, tregim, monolog etj.). Kështu mësuesit të lëndës i del si detyrë, lehtësimit i nxënësve ndaj këtyre proceseve, duke i kërkuar realizimin e detyrave që nuk përbëjnë problem fizik dhe emocional për ta.

Por në këtë grup mund të hyjnë edhe nxënësit me vështirësi në të nxënë me të cilët mund të punohet veçmas, duke i ndihmuar ata të realizojnë detyrat dhe të arrijnë rezultate të kënaqshme.

Për realizimin e këtij programi sigurisht ka nevojë që mësues/i,-ja të dijë të përdorë një metodologji të caktuar edhe për nxënësit e talentuar. Kjo do të thotë që klasa apo grupi që ka zgjedhur këtë lëndë gjithmonë mund të ketë individë, të cilët “shkëlqejnë” apo janë talente të lindur në realizimin e punëve të ndryshme artistike. Për realizimin e këtij programi mësues/i,-ja duhet të evidentojë këta nxënës.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësve nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat programin lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë, duke ndihmuar nxënësit dhe bashkënxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi për shembull:

- 1) të përcaktojnë realizimin më të mirë të një etydi, poezie etj.;
- 2) të përcaktojnë individin më të suksesshëm gjatë debateve për krahasimin e 2 veprave skenike nga periudha të ndryshme duke përcaktuar përmbajtjen, temën, stilin etj.;
- 3) të përcaktojnë shkrimin e esesë më të mirë në trajtimin e çështjeve të artit skenik ku sillen opinione apo mendime, argumentohet dhe krijohet një qëndrim personal ndaj çështjes së ngritur;
- 4) t'i japin çmimin shokut/qes për krijimin më të mirë në veprimtaritë artistike shkollore dhe të komunitetit etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i, -ja vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet në punët konkrete si *realizimi i etydit dhe shfaqja e tij, paraqitja e një poezie dhe monologu nga secili nxënës, interesi në ndjekjen e jetës teatrale në komunitet, pasioni, vlerësimi dhe përkushtimi* ndaj kësaj lëndë shumë të bukur dhe të dashur siç është teatri.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësues/i,-ja duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara gjatë orëve të kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Një formë vlerësimi është edhe provimi përfundimtar i cili përmban (ese), projekte kurrikulare, realizime konkrete (të incizuara të detyrave të ndryshme të

ngarkuara si: etyde, poezi, fragment artistik, monolog etj.), në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj.